

REPubliKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

1646/
Nr. ___ Prot

Tiranë, më 10, 03, 2020

URDHËR

Nr. 95 Datë 10 /03 /2020

“PËR MARRJEN E MASAVE PËR SHËRBIMET NË SPORTELE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, VKM nr.208 datë 10.03.2020, “Për caktimin e datave 10 deri 23 mars 2020 ditë pushimi për prindin kujdestar të fëmijëve të mitur”,

URDHËROJ

- 1) Të gjitha Drejtoritë e Ministrisë së Drejtësisë dhe Institucionet e varësisë së Ministrisë së Drejtësisë, të cilët ofrojnë shërbimet e tyre në sportele apo kanë kontakt të drejtpërdrejtë me publikun, të mundësojnë shërbimin e tyre në mënyrë elektronike.
- 2) Të përdoret shërbimi postar nëse shërbimi i ofruar për shkak të tipologjisë së dokumentacionit të kërkuar nuk mund të kryhet on-line.
- 3) Ministria e Drejtësisë të ndërpresë shërbimet e Pritjes së Popullit, shërbim i cili duhet të bëhet vetëm në rrugë postare.
- 4) Stafii që do të jetë prezent në punë duhet të punojë me masa të shtuara mbrojtëse.
- 5) Stafii që vjen nga zona e konsideruar “zonë e kuqe”, të njoftojë titullarin e institucionit dhe të telefonojnë në numrin e Urgjencës Kombëtare nr. 127.
- 6) Ministria e Drejtësisë dhe Titullarët e Institucioneve të saj të Varësisë të marrin të gjitha masat për të kufizuar çdo aktivitet publik, sesione informuese apo çdo veprimtari tjetër që ka të bëjë me grumbullimin e njerëzve.
- 7) Të anulohet çdo autorizim për udhëtim jashtë vendit pa asnjë përjashtim.
- 8) Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtuesit e Institucioneve të Varësisë së Ministrisë së Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Etilda Gjona
Etilda Gjona (Saliu)

